



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 81.02

Tirane, date 15.7/2015

Drejtuar: Z. JORGOS SAPUNAS
SHOQERIA "IKERAL" SHPK
LAGJIA NR.4, PALLATI 50

SARANDE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.870 date 17.06.2005.

I nderuar z. Sapunas,

Shoqëria "Ikeral" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.870 date 17.06.2005 për mineral argjile, ne objektin "Krekez - Gjashte", Sarande, ne Qarkun Vlore.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 8135 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.870 date 17.06.2005 për mineral argjile, ne objektin "Krekez - Gjashte", Sarande, ne Qarkun Vlore, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Leja ka pasur një afat fillestar 10 vjeçar dhe ne zbatim te pikës nr. 6 te nenit 24 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, kjo leje mund te kishte një zgjatje afati deri ne 10 vite, por kjo shtyrje afati duhet te ishte kërkuar pranë QKL, te paktën 180 dite kalendarike para përfundimit te afatit te vlefshmërisë. Nga shoqëria juaj nuk janë respektuar afatet ligjore te cituara me sipër për zgjatje afati te lejes ne fjale.

Bazuar ne propozimin e Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim qe është i mbështetur ne germen "ç" te pikës 1 te nenit 47 nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, si dhe ne përfundimin e afatit te vlefshmërisë se lejes, i gjejmë te plotësuar shkaqet ligjore për te cilat një e drejte minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit nr.870 date 17.06.2005 për mineral argjile, ne objektin "Krekez - Gjashte", Sarande, ne Qarkun Vlore, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes nr.870 date 17.06.2005 për mineral argjile, ne objektin "Krekez - Gjashte", Sarande, ne Qarkun Vlore.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

